



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA Durrës
DREJTORIA LIGJORE**

PROJEKTVENDIM

NR.____, DATË ____/____/2026

**PËR RIALOKIMIN E FONDEVE TË PËRFITUARA NGA FONDI I RINDËRTIMIT I
BUXHETIT TË SHETIT, TË PASHPËRNDARA NË VITIN 2025, QË DO TË
TRASHËGOHEN NË VITIN 2026.**

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17/12/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, ligjit nr.9936, dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 762, datë 19.12.2025 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të njësive individuale të banimit në Bashkinë Durrës”, Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 767, datë 19.12.2025 Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, dhe shkëmbimin e pronës, në funksion të procesit të rindërtimit, në zonën e re për zhvillim në Spitallë, Bashkia Durrës, në kuadër të projektit “Rikonstruksioni i rrugëve ‘Miqësia’ dhe ‘Azem Hajdari’, loti II – rruga ‘Miqësia’”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 816, datë 30.12.2025 “Për disa shtesa në vendimin nr. 837, datë 26.12.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të banesave individuale në bashkitë Durrës, Kamzë, Mirditë, Shijak, Krujë dhe Vorë”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore”, të Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave nr. 2 datë 24.01.2025 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2025”, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria Ekonomike, kryetari i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak Durrës të gjykojë konform akteve ligjore dhe,

TË VENDOSË:

1. Fondet e përfituara nga Fondi i Rindërtimit i buxhetit të shtetit në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.762 datë 19.12.2025, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.767 datë 19.12.2025 dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.816 datë 30.12.2025, në total me vlerë 320,423,765 lekë dhe i pashpërndarë në vitin 2025, trashëgohet në vitin 2026 dhe do të përdoret sipas tabelës së mëposhtme:

Në lekë

Nr.	VKM qe ka miratuar fondin	Emertimi i produktit	Kodi i produktit	Kapitull	Program	Llogaria ekonomike	Fondi sipas VKM	Vlera e mbartur nga 2025
1	VKM nr. 762 dt. 19.12.2025	Rikonstruksion/riparim I banesave individuale, I mjediseve ne bashkepronesi ose te perbashketa te njesive te banimit	94902AB	1	04960	606	169,850,000	169,850,000
2	VKM nr. 767 dt. 19.12.2025	Shpronësim për zhvillimin e njësive pas tërmetit	94902AG	1	4960	231	13,929,889	13,929,889
3	VKM nr. 816 dt. 30.12.2025	Rindertim I banesave individuale	94902AC	1	04960	606	341,609,690	136,643,876
		TOTALI						320,423,765

2. Ngarkohet Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria Ligjore, Zyra e Posacme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

DREJTORIA E BUXHETIT

Drejtör

Valbona Qirjako



DREJTORIA LIGJORE

Drejtör


Alceida Rroshi



DREJTORIA EKONOMIKE


Drejtör

Ina ferra



KRYETAR

Emiriana Sako





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës
DREJTORIA E BUXHETIT

RELACION

**Për rialokimin e fondeve të përfituara nga fondi i Rindërtimit i buxhetit të shtetit ,
të pashpërndara në vitin 2025, që do të trashëgohe në vitin 2026**

Në dhjetor të vitit 2025 me vendime të vecanta të Këshillit të Ministrave janë miratuar fondet në kuadër të procesit të rindërtimit si më poshtë:

- Me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.762 dt.19.12.2025 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rikonstruksionit të njësive individuale të banimit, në Bashkinë Durrës”, është miratuar fondi prej 169 850 000 (njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë milionë e tetëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit të njësive individuale të banimit në Bashkinë Durrës. Efekti financiar përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2025, dhe i transferohet Bashkisë Durrës në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rikonstruksionit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë si pasojë e fatkeqësisë natyrore dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime. Ky vendim është në vijim të vendimit nr.11 datë 28.01.2022 të Komisionit Shtetëror Rindërtimit dhe ky i fundit është në vijim të Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës nr.11 datë 28.01.2022 “Për miratimin e dhënies së ndihmës financiare sipas listës së trembëdhjetë me subjektet përfituese të programit të grantit për rikonstruksionin e banesave të dëmtuara si pasojë e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”. Referuar këtij vendimi Bashkia Durrës i është drejtuar Ministrisë së Shtetit për Rindërtim si dhe Komisionit të Shtetit për Rindërtim me shkresën nr. 2453 date 17.03.2022 me lëndë: Kërkesë për miratimin e fondit 169.850.000 lekë për grantet e rikonstruksionit për familjet e dëmtuara nga tërmeti me nivel dëmi DSI – Ds3. Komisioni Shtetëror i Rindërtimit me vendim nr. 11 datë 28.01.2022 ka miratuar vlerën 169.850.000 lekë për 526 familje.
Fondi prej 169.850.000 lekë është alokuar me shkresën e Ministrisë së Financave nr.15850 dt. 31.12.2025 .
- Me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.767 dt. 19.12.2025 “Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private dhe shkëmbimin e pronës, në funksion të procesit të rindërtimit, në zonën e re për zhvillim në Spitallë, Bashkia Durrës, në kuadër të projektit “Rikonstruksion i rrugëve “Miqësia” dhe “Azem

Hajdari”, Loti II – rruga “Miqësia”, është miratuar fondi prej 13.929.889 lekë pa TVSH. Vendimi i sipërpërmendur është në zbatim të vendimit nr. 164 datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim, në Njësinë Administrative Durrës, Bashkia Durrës dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese”. Shpronësimi dhe shkëmbimi i pronës bëhen në favor të Bashkisë Durrës. Shkëmbimi i pasurive të paluajtshme, pronë private, për të cilat pronarët kanë pranuar kompensimin, me shkëmbim, për pasuritë e llojit “ndërtesë” dhe “truall”, me një pasuri të ardhshme në pronësi të shtetit, bëhet referuar legjislacionit në fuqi, sipas cilësimeve në tabelën që i bashkëlidhet VKM-së, si dhe marrëveshjeve/kontratave paraprake, që janë lidhur dhe lidhen ndërmjet Bashkisë Durrës dhe qytetarëve, që shprehin dakordësinë brenda periudhës së zbatimit të projektit. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i është bashkëlidhur VKM nr.767 dt.19.12.2025, për pasuritë e llojit “truall”, “ndërtesë”, “njësi” dhe “arë”. Vlera e përgjithshme e kompensimit, prej 13 929 889 (trembëdhjetë milionë e nëntëqind e njëzet e nëntë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë, përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit, që i transferohen Bashkisë Durrës. Pronarët e pasqyruar në VKM, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur certifikatën e pronësisë origjinale ose dublikatë, kartelën e pasurisë të rifreskuar, si dhe hartën treguese të regjistrimit pranë Bashkisë Durrës, referuar aktmarrëveshjes . Janë 38 pasuri pronë private që shpronësohen brenda kësaj vlere.

Fondi në zbatim të këtij vendimi është alokuar me shkresën e Minsitrisë së Financave nr. 15816 dt. 31.12.2025.

- Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.816 dt.30.12.2025 “Për disa shtesa në vendimin nr.837, datë 26.12.2024, të Këshillit të Ministrave, për financimin e rindërtimit të banesave individuale në Bashkitë, Durrës, Kamzë, Mirditë, Shijak, Krujë dhe Vorë”, është miratuar fondi prej 136.643.876 lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para, në bazë të aktekspertizave të thelluara, Efekti financiar përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2025, dhe i transferohet Bashkisë Durrës në formën e transfertës së pakushtëzua. Bazuar në VKM NR. 837 dt. 26.12.2024 fondi në total për financimin e projektit është 341,609,690 lekë. Gjatë vitit 2024 u alokua vlera prej 204,965,814 lekë dhe në 2025 u alokua pjesa e mbetur prej 136,643,876 lekë. Fondi prej 136.643.876 lekë është alokuar me shkresën e Minsitrisë së Financave nr.16 dt.05.01.2026.

Në total fondet e alokuara janë në shumën 320,423,765 lekë, dhe sikurse shihet nga data e alokimit, përdorimi i këtyre fondeve brenda vitit 2025 ishte i pamundur. Ato janë alokuar në formën e transfertës së pakushtëzuar dhe si të tilla mbarten për vitin pasardhës.

Fondet e alokuara në kuadër të procesit të rindërtimit mbarten me të njëjtin destinacion.

Për sa më sipër i propozojmë Këshillit Bashkiak të vendosë :

1. Fondi i përfituar nga Fondi i Rindërtimit i buxhetit të shtetit në zbatim të vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.762 datë 19.12.2025, nr.767 datë 19.12.2025 dhe nr.816 datë 30.12.2025, prej 320,423,765 lekë dhe i pashpërndarë në vitin 2025, trashëgohet në vitin 2026 dhe do të përoret sipas tabelës së mëposhtëme:

Në lekë

Nr.	VKM qe ka miratuar fondin	Emertimi i produktit	Kodi i produktit	Kapitull	Program	Llogaria ekonomike	Fondi sipas VKM	Vlera e mbartur nga 2025
1	VKM nr. 762 dt. 19.12.2025	Rikonstruksion/riparim I banesave individuale, I mjediseve ne bashkepronesi ose te perbashketa te njesive te banimit	94902AB	1	04960	606	169,850,000	169,850,000
2	VKM nr. 767 dt. 19.12.2025	Shpronësim për zhvillimin e njesive pas tërmetit	94902AG	1	4960	231	13,929,889	13,929,889
3	VKM nr. 816 dt. 30.12.2025	Rindertim I banesave individuale	94902AC	1	04960	606	341,609,690	136,643,876
		TOTALI						320,423,765

2. Ngarkohet Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria Ligjore, Zyra e Posacme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike për zbatimin e këtij vendimi.

Duke ju flenderuar për bashkëpunimin

Dr. Drejtorisë Buxhetit

Valbona Qiriako

Dr. Drejtorisë Ligjore

Aneida Rroshi

Dr. Drejtorisë Ekonomike

Ina Ferra